



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20 Tetor 2023

Nr: 810

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT REGJISTRUAR ME NR. 412 ID, TË QENDRËS “QËNDRESA QYTETARE”, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 20 Tetor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”

SUBJEKT: Z. Beqir Mulaj, kandidat për kryetar për bashkinë Has
Zj. Mirjeta Gjoni, drejtor i shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, fshati Helshan, Has

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, neni 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka administruar denonimin e përcjellë nga Organizata Qendra "Qëndresa Qytetare", nëpërmjet së cilit pretendohet shkelje administrative nga ana e kandidatit për kryetar për bashkinë Has si dhe nga ana e drejtorit të shkollës 9-vjeçare "Sali Hajdari", në Helshan, Has.

Denoncimi është administruar nëpërmjet shkresës nr. 4858 prot., datë 09.05.2023, nëpërmjet së cilës janë vënë në dispozicion dhe prova të shkëputura nga postimi i z. Mulaj si dhe *screen print* nga postimi i z. Mulaj.

Denoncimi regjistruar me nr. 412 ID regjistri, ndaj z. Beqir Mulaj, Kandidat për kryetar bashkie Has, i subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, si dhe zj. Mirjeta Gjoni, Drejtor i shkollës 9 vjeçare "Sali Hajdari", Helshan, Has për 1 (një) veprimtari publike, për të cilin pretendohet si vijon:

"Më datë 3 Maj 2023, në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare "Sali Hajdari", në fshatin Helshan, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Hasit, Z. Beqir Mulaj dhe banorëve të këtij fshati. Ky aktivitet është pasqyruar dhe në rrjetet sociale të kandidatit.

Kandidati e ka shoqëruar postimin e këtij takim me përshkrimin: "Duam punë, jo fjalë. Veprat janë ato që na duhen për të zhvilluar bujqësinë, belgtorinë dhe për të ndërtuar infrastrukturën rrugore, e cila na favorizon për daljen në treg të prodhimeve tona. Kjo ishte kërkesa që mu artikulua këtë të mërkurë teksa realizuam takime me banorë të Kosturrit, Helshanit dhe Perollajve. Demagogjia nuk ka vend te Ne, pasi Ne duam njeriun e punës, jo të mendojë për hallet e veta, theksuan më tej banorët e këtyre tri fshatrave, të cilët konstatova se më 14 Maj do të votojnë për të ecur përpara dhe jo mbrapa. Shumë i lumtur që ata kishin diskutuar edhe përpara programin tonë, pasi e konsiderojnë si të duhurin për Hasin me perspektivë për çdo fëmijë, të ri apo të re, prind, të moshuar, fermer, blegtor, bletar, biznes i vogël apo edhe qytetar i thjeshtë! Mirënjohës pafund që mora mbështetjen e tyre, falë së cilës më 14 Maj fitorja është e sigurtë!"

Neni 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e depozituara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi hetimi administrativ duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtarinë publike për të cilat nga pala denoncuese pretendohet se është kryer shkelje administrative.

Nëpërmjet adresës elektronike, më datë 11.05.2023, palëve ne proces, i është kërkuar informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

Më datë 12.5.2023, Zyra Vendore Arsimore Has, bën me dije se: *"Në lidhje me zhvillimin e aktivitetit politik në mjediset e shkollës 9-vjeçare "Sali Hajdari" Helshan, nga z. Beqir Mulaj kandidat i Partisë Socialiste për bashkinë Has. Pas pamjeve të materialit dhe fotografive bashkëlidhur denoncimit, Ju informojmë se aktiviteti është zhvilluar jashtë procesit mësimorë diku rreth orës 16:30 dhe brenda oborrit të kësaj shkolle. Në këtë aktivitet nuk janë përdorur materialet e shkollës në mbështetje të këtij aktiviteti."*

Për shkak të kompleksitetit të çështjes, nëpërmjet vendimit nr. 687, datë 09.07.2023 "Për zgjatjen e afatit të denoncimeve regjistruar me nr. 405 ID, 410 ID, 412 ID, 413 ID dhe 414 ID për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023", vendosa zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 412 ID.

Në vijim të shqyrtimit administrativ, pas konsultimit me të gjitha provat dhe faktet, më datë 27 Korrik 2023 nëpërmjet postës elektronike, palëve në këtë proces i është kërkuar paraqitja e pretendimeve përfundimtare përpara se të vijohet me vendimmarrje. Personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në përgjigje të kërkesës sonë për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare ndër të tjera bën me dije se: *"Ditën e zhvillimit të aktivitetit politik të zhvilluar në mjediset e jashtme të shkollës 9-vjeçare "Sali Hajdari", Helshan, Has, janë bërë pa dijeninë e drejtueses së shkollës zj. Mirjeta Gjoni, e cila nuk është njoftuar për zhvillimin e takimit elektorale dhe se nuk i është marrë leje si drejtuese e shkollës. Nga ana tjetër shkolla është e rrethuar me rrethim, por porta e jashtme të saj janë pa çelës".*

Në vijim të hetimit administrativ, palët në procesin administrativ u njoftuan për të marrë pjesë në seancën publike të datës 06.10.2023 për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në seancë publike u paraqit përfaqësuesi i Organizatës Qendra "Qëndresa Qytetare", i cili gjatë deklarimeve të tij i qëndroi argumentave të depozituara nëpërmjet shkresës nr. 4858, datë 09.05.2023.

Palët e tjera në process nuk u paraqitën për të dhënë shpjegime në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi.

Më datë 20.10.2023, palët në process u njoftuan për zhvillimin e seancës publike, për të parashtruar konkluzionet përfundimtare, në seancë u paraqit vetëm përfaqësuesi i Organizatës Qendra “Qëndresa Qytetare”, i cili në dhënien e konkluzioneve përfundimtare parashtrroi faktin se kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 09, datë 24.12.2020, të cilat duhet të bëjnë më përgjegjësi subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, si dhe drejtorin e shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, Helshan, Has, i cili ka vënë në mbështetje të këtij takimi, bazë materiale të shkollës si karrige dhe tavolina.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve në denoncimin e regjistruara me nr. **412 ID**, vlerësoj se:

Nga pamjet fotografike të administruar agjatë seancës publike, rezultoi e provuar se veprimtaria me karakter publik është kryer në ambientin e jashtëm të institucionit publik, konkretisht në oborrin e shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, Helshan, Has.

Nga sa evidentohet nga deklarimi i mbajtur në postimin publik në faqen zyrtare në “facebook” të kandidatit z. Beqir Mulaj, vihet re se kemi të bëjmë me një takim me karakter elektoral, ku është diskutuar mbi programin dhe garantimin e mbështetjes në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, ndaj kandidate për kryetar bashkie në bashkinë Has, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Neni 91, pika 1, e Kodit Zgjedhor parashikon se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”* Komisioni Rregullator, në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, në nenin 3, pika 1.3/c, qartësisht ka përcaktuar se *“veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: “vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo enteve publike në nivel qendror ose të njërive të vetëqeverisjes vendore, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit”.*

Rezultoi e provuar gjithashtu se kandidati për kryetar të bashkisë Has, me zhvillimin e këtij aktiviteti elektorale në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, Helshan, Has, konstatohet se **ka përdorur burime publike** në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore.

Në kuptim të nenit 172, pika 1 të Kodit Zgjedhor, subjektet zgjedhore ndëshkohen administrativisht në rastet kur në favor të tyre kryhen shkelje të ndalimeve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, me parakushtin që subjekti zgjedhor, të ketë marrë dënim dhe pas marrjes dënim të mos ketë marra masa të menjëhershme për ndërprerjen e shkeljes. Në rastin objekt shqyrtimi, nuk u provua që subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, të jetë vënë në dënim të kësaj shkelje. Për sa më sipër, përgjegjësia administrative i atashohet personave që kanë për detyrë mirëadministrimin e këtij aseti në përputhje me parashikimet e ligjit dhe akteve nënligjore duke u përjashtuar nga përgjegjësia partia politike apo kandidatit për deputet që mund të ketë kryer këtë aktivitet për qëllime të fushatës së tij elektorale.

Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, vlerësoj se në rastin e denoncimit **nr. 412 ID**, drejtori i shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, Helshan, Has, zj. Mirjeta Gjoni si personi përgjegjës për administrimin e institucionit arsimor, nuk provohet që të ketë lejuar përdorimin nga kandidati për kryetar bashkie, të ambienteve të shkollës për qëllime zgjedhore.

Gjithashtu nuk provohet që drejtori i shkollës 9 vjeçare “Sali Hajdari, Helshan, Has të ketë qënë në dënim të kryerjes së aktivitetit brenda murit rrethues të institucionit arsimor që ai drejton.

Gjithashtu nuk provohet që Zyra Vendore Arsimore Has, të ketë qënë në dënim të kryerjes së aktivitetit publik të zhvilluar në ambientet e shkollës 9 vjeçare “Sali Hajdari, Helshan, Has.

Për sa më sipër vlerësoj se të ndodhur në këto kushte, duhet të pushohet hetimi administrativ si për z. Beqir Muaj, kandidat për kryetar në bashkinë Has, po ashtu edhe për zj. Mirjeta Gjoni drejtor i shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, Helshan, Has.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Data: 20 Tetor 2023 Nr: 810
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 412 ID, për shkelje administrative”

V E N D O S:

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes ndaj:
 - Z. Beqir Mema, kandidat për kryetar bashkie në bashkinë Has;
 - Zj. Mirjeta Gjoni, drejtori i shkollës 9-vjeçare “Sali Hajdari”, Helshan, Has.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Kopje: 4

Afati i ruajtjes: 5

vjet

Punoi:

I.Horanlliu _____

M.Koja _____

A. Lamçe _____

Y.Merkaj _____

Ilirjan CELIBASHI

Data: 20 Tetor 2023 Nr: 810
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 412 ID, për shkelje administrative”